VENDIM
Nr.85, datë 27.12.2005

PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA "FAVINA" SHPK TE SHOQËRIA "FAVINA 1" SHPK

Në mbështetje të nenit 9, nenit 20 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", si dhe pikës 1.4 "Kushtet e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet elektrike ekzistuese me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW", Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 27.12.2005, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria "Favina 1" sh.p.k. për transferimin e licencës nga shoqëria "Favina" sh.p.k. te shoqëria "Favina 1" sh.p.k. për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në hidrocentralin e Vithkuqit të Rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës nga shoqëria "Favina" sh.p.k. te shoqëria "Favina 1" sh.p.k. me një afat kohor 5-vjeçar.
2. Miratimin e transferimit të aseteve të shoqërisë "Favina" sh.p.k, te shoqëria "Favina 1" sh.p.k. me të njëjtën vlerë aseti.
3. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.26 të datës 27.05.2005 "Për licencimin e shoqërisë "Favina" sh.p.k. për prodhimin e energjisë elektrike për hidrocentralin e Vithkuqit të Rrethit të Korçës".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema